



10.09. 2015

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Gjykatës Kushtetuese shpall të papranueshme kërkesat e paditësve për Hotelin Grand

Prishtinë – Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Aktvendimin nr. KL 168-14 ku parashtrues i kërkesës ka qenë NTP Union Commerce dhe Aktvendimin nr. KL167-14 me parashtruesit e kërkesës Mab Constructiones/EuroKoha Reisen për të vlerësuar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në lidhje me Hotelin Grand.

Parashtruesit e kërkesës kanë kontestuar Aktgjykimin e datës 26 qershor të 2014 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nr. AC-I-13-0045-A0001 për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me çka ishte vlerësuar i drejtë vendimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS dhe vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së për tërheqje të aksioneve në ndërmarrjen Hoteli Grand.

Gjykata Kushtetuese e ka shpallur të papranueshme kërkesën e parashtruesit NTP Union Commerce dhe pretendimet e tij se ka pasur shkelje me vendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, ndërsa ka vlerësuar si të papranueshme poashtu edhe kërkesën e parashtruesit Mabco Constructions dhe Eurokoha-Reisen, të cilët kishin kërkuar për të qenë ndërhyrës në anën e paditësit.

Për më shumë detaje, palët ftohen t'i referohen faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese.

FUND